



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Sot paradite, Paneli i Gjykatës së Apelit në çështjen gjyqësore *Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës*, i përbërë nga gjykatësit Mishelë Pikar, Kai Ambos dhe Nina Jorgensen, shqiptoi aktgjykimin e parë të apelit të Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK) në një çështje gjyqësore që ka lidhje me krime lufte.

Paneli i Apelit la në fuqi verdiktet e fajësisë së z. Mustafa për krimet e luftës të ndalimit arbitrar (Pika 1 e Aktakuzës), torturës (Pika 3 e Aktakuzës) dhe vrasjes së paligjshme (Pika 4 e Aktakuzës).

Apeli i z. Mustafa përmbante nëntë pika të ndara në 51 nënpika. Paneli i Apelit rrëzoi tetë pika të paraqitura nga z. Mustafa që kundërshtonin Aktgjykimin e Trupit Gjyqësor, ndërsa miratoi pjesërisht kundërshtimin e tij ndaj dënimit me 26 vjet burgim nga Trupi Gjyqësor për tri pikat e Aktakuzës që ishte shpallur fajtor.

Ndonëse plotësisht i vetëdijshëm për diskrecionin e gjerë të Trupit Gjyqësor në dhënien e dënimit, dhe duke pasur parasysh se dënimet nuk mund të zhvendosen lehtë nga një çështje gjyqësore në tjetrën, gjithsesi Paneli i Apelit konstatoi se në çështjet e gjykuara si në tribunalë penale dhe në gjykatat e Kosovës lidhur me krime lufte të krahasueshme me ato për të cilat u dënua z. Mustafa, dënimet e dhëna ishin më të shkurtra se dënimi i z. Mustafa nga Trupi Gjyqësor.

Rrjedhimisht, Paneli i Apelit zvogëloi dënimet individuale të dhëna z. Mustafa për krimet e luftës që ishte shpallur fajtor dhe zvogëloi dënimin e njëzuar nga 26 në 22 vjet burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim.

Gjatë shqiptimit të Aktgjykimit, Paneli i Gjykatës së Apelit theksoi se Aktgjykimi “është një hap i rëndësishëm drejt vendosjes së drejtësisë për viktimat dhe llogaridhënies,” dhe se zvogëlimi i dënimit të z. Mustafa “nuk sugjeron aspak se krimet për të cilat ai është shpallur fajtor dhe dënuar, nuk janë të rënda.”

Paneli i Apelit vuri në dukje se z. Mustafa nuk apeloj Urdhrin për Zhdëmtim të lëshuar nga Trupi Gjyqësor, në të cilin tetë viktimave pjesëmarrëse në proces iu akorduan dëmshpërblime, dhe se vendimi i këtij paneli nuk ndikon në Urdhrin për Zhdëmtim.

Paneli i Apelit gjithashtu theksoi se la në fuqi verdiktet e fajësisë së z. Mustafa në të cilat u konstatua se ai mbante “përgjegjësi penale individuale” për krimet e luftës të torturës, ndalimit arbitrar dhe vrasjes së paligjshme dhe se “as UÇK-ja, as populli i Kosovës nuk ishin objekt i këtij procesi gjyqësor dhe nuk mbahen përgjegjës apo fajtorë për këto krime.”

Përmbledhja e Aktgjykimit të Apelit gjendet në [faqen e internetit të DHSK-së](#).





Kryetarja e Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK), EKaterina Trendafilova, më 12 dhjetor 2023, vendosi të modifikojë dënimin e z. Haradinaj për lirimin e tij më 14 dhjetor, ose rreth asaj date, me kushtet e përcaktuara në vendim.

Në përputhje me vendimin, z. Haradinaj u lirua sot.

Kushtet e lirimit të tij do të jenë në fuqi gjatë gjithë kohëzgjatjes së dënimit me burgim që i është shqiptuar nga Paneli i Gjykatës së Apelit, përkatësisht për pjesën tjetër të mbetur të dënimit prej katër vjet e tre muaj.

Kryetarja gjykoi se ndonëse veprat penale për të cilat u dënua z. Haradinaj janë padyshim të rënda, ishin një sërë faktorësh që peshuan në favor të modifikimit të dënimit të tij.

Konkretisht, Kryetarja konstatoi se z. Haradinaj pati mundësinë të reflektonte për veprimet e tij gjatë kohës së kaluar në objektin e paraburgimit të DHSK-së dhe se raporti i fundit i marrë nga Administratorja tregoi se ai kishte respektuar rregullat e objektit të paraburgimit gjatë muajve të kaluar. Kryetarja theksoi më tej pendesën e shprehur nga z. Haradinaj dhe zotimin e tij se nuk do të përfshihet më në sjellje që mund të karakterizohen si vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe se do t'i përmbushë të gjitha kushtet që mund të vendosen për lirimin e tij

Kryetarja theksoi se nëse z. Haradinaj nuk respekton cilindo prej kushteve të përcaktuara në vendim, vendimi do të shfuqizohet.

Në zhvillime të tjera, të hënën, më 11 dhjetor 2023, z. Haxhi Shala u arrestua në Kosovë nga Zyra e Prokurorit të Specializuar, në bazë të fletarrestimit, urdhrin të transferimit dhe aktakuzës së konfirmuar të lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake të Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Haxhi Shala u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara të nesërmen, më 12 dhjetor dhe paraqitja e parë e tij para Gjykatësit të Procedurës Paraprake u mbajt më 13 dhjetor.

Gjatë paraqitjes së parë Gjykatësi i Procedurës Paraprake garanton respektimin e të drejtave të të akuzuarit, përfshirë të drejtën për përfaqësim juridik, dhe se i akuzuari i kupton akuzat e ngritura kundër tij.

Aktakuza e konfirmuar akuzon Haxhi Shalën për frikësim dhe tentativë me anë të kërcënimit të rëndë për të penguar personat zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, individualisht dhe me anë të pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi.

Akuzat kanë të bëjnë me takime të pretenduara me një dëshmitar për ta nxitur atë që të tërhiqte dëshminë, ose të mos jepte dëshmi në proceset zyrtare para Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Konferenca e parë mbi ecurinë në këtë çështje gjyqësore është caktuar të mbahet nesër, më 15 dhjetor, në orën 09:30.





Në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët*, të enjten e kaluar dhe të hënën e kësaj jave, ish-zyrtarja e OSBE-së, Sandra Miçell (Sandra Mitchell) vazhdoi me dhënien e dëshmisë.

Të hënën, dëshmitari i 39-të i thirrur nga Prokuroria në këtë çështje gjyqësore filloi me dhënien e dëshmisë. Sipas përmbledhjes së shkurtër të lexuar në sallë të gjyqit nga Prokuroria, dëshmitari ishte arrestuar nga shqiptarët të armatosur në korrik 1998, disa nga të cilët kishin të veshur uniforma të zeza, dhe më pas ishte dërguar në Budakovë.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 12 dhjetor, Trupi Gjyqës miratoi pjesërisht kërkesën e Prokurores së Specializuar për të pranuar si prova disa deklarata të dëshmitarëve, së bashku me dokumentacion dhe prova materiale shoqëruese me shkrim. Më 13 dhjetor, Trupi Gjyqës miratoi kërkesën e Prokurorisë për të urdhëruar masa për mundësimin e dhënies së dëshmisë në sallë të gjyqit nga një dëshmitar i punësuar në një organizatë ndërkombëtare.

Në fillim të seancën të së martës, Mbrojtja e Kadri Veselit kërkoi shtyrje të seancës për këtë javë për shkak të vdekjes së papritur dhe tragjike të anëtarit të ekipit të Mbrojtjes, Endrju Strong (Andrew Strong). Trupi Gjyqës anuloi seancat e caktuara për këtë javë. Gjykimi do të rifillojë më 15 janar 2024.

U shprehim ngushëllimet më të thella familjes dhe miqve të Endrju Strong.

Në gjykimin e Pjetër Shalës, më 11 dhjetor, Trupi Gjyqës lëshoi vendimin e katërt për heqjen e redaktimeve ose përfshirjen e redaktimeve të reja në transkripte të seancave dhe riklasifikim të tyre. Për të respektuar parimin e gjykimit publik, Trupi Gjyqës autorizoi, ndër të tjera, riklasifikimin si publike të pjesëve të transkripteve të seancave private të mbajtura midis 21 gushtit dhe 3 tetorit 2023.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 12 dhjetor, Trupi Gjyqës miratoi kërkesën e Mbrojtjes për pranim si provë të një materiali që lidhet me dëshminë e një dëshmitari.

Seanca vijuese në gjykimin e Pjetër Shalës është caktuar të mbahet pas pushimit dimëror të gjykatës, më 9 janar 2024.

Në çështjen gjyqësore *Sabit Januzi dhe Ismet Bahtijari*, konferenca e tretë mbi ecurinë e çështjes mbahet sot, më 14 dhjetor. Në urdhrin e caktimit të datës së seancës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake u kërkoi palëve të shprehnin mendime lidhur me kalimin e dosjes së çështjes gjyqësore Trupit Gjyqës deri më 15 mars 2024, dhe përditësimet se kur presin palët të janë gati për gjykim.

Në lajme të tjera, pushimi dimëror i DHSK-së fillon të hënën, 18 dhjetor dhe zgjat deri të premtën, 5 janar 2024. Gjatë kësaj periudhe, nuk ka seanca, dhe disa shërbime jothemelore funksionojnë në nivel minimal. Megjithatë, gjykata do të jetë në funksionim të plotë dhe puna do të vijojë si zakonisht në të gjitha njësitet e DHSK-së.





Gjatë pushimit mund të dorëzohen parashtrime, përveç nëse gjykatësit urdhërojnë ndryshe dhe afatet gjyqësore vijojnë të jenë në fuqi. Gjatë pushimit të gjykatës nuk do të ketë përditësime për median, që do të thotë se përditësimi i ardhshëm i DHSK-së për median është caktuar për të enjten, 11 janar 2023, në orën 14:30.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

